



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo za Financije, Rada i Transfera

Ministry of Finance, Labor and Transfers

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS  
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA  
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

# Statistikat Afatshkurtëra të Tregtisë me Pakicë

## TM4 2021

**Prishtinë, 16.03.2022** Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgatitur publikimin e rezultateve të Statistikave Afatshkurtra të Tregtisë me pakicë duke paraqitur indeksin e qarkullimit për periudhën TM4 – 2021 (2017=100).

Këto statistika janë pjesë përbërëse e Programit statistikor të ASK - së, dhe bazohen në deklaratimet e ndërmarrjeve. Ky hulumtim publikohet në baza të rregullta tremujore.

Rezultatet e këtij hulumtimi paraqesin ecurinë në tregtinë me pakicë në periudha tremujore.

Rezultatet e këtij hulumtimi në të njëjtën kohë përdoren për nevoja të përpilimit të llogarive kombëtare dhe janë burim i rëndësishëm në përpilimin e Bruto Produktit Vendor me qasjen e prodhimit dhe shpenzimeve në baza tremujore.

Ky publikim do t'i nënshtrohet revidimit.

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja mund ti dërgoni në adresën e ueb faqes: [infoask@rks-gov.net](mailto:infoask@rks-gov.net)

### Publikimi është përgatitur nga:

- Ismajl Sahiti – Zëvendësues i Drejtorit të Departamentit
- Hysni Elshani – Zëvendësues i Udhëheqësit të Divizionit të Statistikave Ekonomike
- Bekim Bojku – Zyrtar i Statistikave Ekonomike
- Dafina Kumnova – Zyrtare e statistikave ekonomike
- Guxim Neziri – Zyrtar i TI-së për Statistika Ekonomike
- Vivianit Fejza – Zyrtar i statistikave të shërbimeve
- Ahmet Cakolli – Zyrtar për Dizajn

Mars, 2022

Zv. i Kryeshefit Ekzekutiv ASK-së  
z. Ilir T.Berisha

**Simbolet dhe shkurtesat**

**ASK** - Agjencia e Statistikave të Kosovës  
**NVE** - Nomenklatura e veprimtarive ekonomike  
**RSB** - Regjistri Statistikorë i Bizneseve  
**SAN** - Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve

**TM1** - Tremujori i parë  
**TM2** - Tremujori i dytë  
**TM3** - Tremujori i tretë  
**TM4** - Tremujori i katërt

**Simbolet**

**:** - Mungojnë të dhënat  
**N/A** - Nuk aplikohet

## Përmbajtja

<b>1</b>	Objektivi, metodologjia dhe shtrirja e anketës.....	4
1.1.	Objektivi dhe qëllimi.....	4
1.2.	Fusha e mbulimit.....	4
1.3.	Procedurat e mbledhjes (grumbullimit) të të dhënave.....	4
1.4.	Korniza për mostër dhe përzgjedhja e mostrës.....	4
<b>2.</b>	Definicione, përkufizime dhe treguesit themelorë	
2.1.	Definicione dhe përkufizime.....	6
2.2.	Treguesit themelorë.....	6
<b>3.</b>	Tregtia me Pakicë.....	7
3.1.	Struktura e qarkullimit.....	7
3.2.	Numri i të punësuarve .....	7
<b>4.</b>	Indeksi i vëllimit të qarkullimit dhe numrit të të punësuarve .....	8
4.1.	Indeksi i qarkullimit .....	8
4.2.	Indeksi i numrit të të punësuarve .....	11

## 1 Objektivi, metodologjia dhe shtrirja e anketës

### 1.1. Objektivi dhe qëllimi

Objektivi kryesor i Anketës së Statistikave afatshkurtra të ndërmarrjeve tregtare është paraqitja e trendëve nëpër periudha tremujore në sektorin e tregtisë me pakicë, nëpërmjet disa treguesve ekonomik, që mundëson krahasueshmërin e të dhënave në nivel ndërkombëtar duke pasur parasysh standardet Evropiane për statistikat tremujore. Anketa synon t'i plotësojë kërkesat për informacione më të plota statistikore në kushtet e ekonomisë së tregut dhe ofron të dhëna mbi aktivitetet ekonomike të ndërmarrjeve në sektorin e tregtisë me pakicë.

Qëllimi - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt.

Vrojtimi tremujor ka për qëllim të paraqesë ecurinë e treguesve kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore.

### 1.2. Fusha e mbulimit

Bazuar në aktivitetin kryesor, në këtë anketë tremujore janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete: Statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve ekonomike në sektorin e tregtisë me pakicë, publikojnë të dhënat e tremujorit të katërtë 2024 sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2 . Në mënyrë që të reflektohen ndryshimet e ndodhura në strukturën e ekonomisë, të gjithë treguesit në këtë tremujor paraqiten me bazë të përditësuar nga tremujori i parë 2019. Anketa mbulon në mënyrë të përmbledhur, sektorin e tregtisë me pakicë.

Metodologjia e përdorur për përpilimin e instrumenteve për anketë, nomenklatura dhe përgatitja e të dhënave për publikim, është sipas rregullave dhe rekomandimeve të EUROSTAT- it. Pyetësi është përpiluar në bashkëpunim me ekspert të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Anketa është kryer në tërë territorin e Kosovës dhe përfshinë të në sektorin e tregtisë me pakicë.

### 1.3. Procedurat e mbledhjes (grumbullimit) të të dhënave

Burim i të dhënave kanë qenë të dhënat administrative respektivisht Regjistri statistikor i Bizneseve, ku jemi bazuar kryesisht në deklaratimet e bëra nga ana e bizneseve në ATK.

## 1.4. Korniza për mostër dhe përzgjedhja e mostrës

Për krijimin (përcaktimin) e kornizës së mostrës janë shfrytëzuar të dhënat nga regjistri statistikor i bizneseve. Të gjitha ndërmarrjet që kanë deklaruar njërin nga tatimet gjatë viteve referuese për vitet paraprake janë konsideruar aktive.

Përzgjedhja e mostrës është bërë në bazë të kriterit ku janë përfshirë të gjitha ndërmarrjet që përfaqësojnë 80% të qarkullimit për aktivitetin përkatës të NVE Rev2. Numri i ndërmarrjeve të përfshira në anketë është 846, në sektorin e tregtisë me pakicë.

## 2 Definicione, përkufizime dhe treguesit themelorë

### 2.1. Definicione dhe përkufizime

**Ndërmarrja** është njësi më e vogël e kombinimit të njësisë legale me njësinë e prodhimit të produkteve ose shërbimeve e cila ka pavarësi në vendim-marrje, sidomos për përdorimin e burimeve të saj materiale e monetare. Një ndërmarrje mund të ushtrojë një ose disa aktivitete ekonomike.

**Ndërmarrje aktive** - konsiderohen vetëm ato ndërmarrje që kanë deklaruar njërin nga tatimet apo ndonjë të punësuar për vitin referues.

**Vlera e qarkullimit nga tregtia me pakicë** - paraqet qarkullimin e realizuar nga tregtia duke përjashtuar tatimin mbi vlerën e shtuar.

**Indekset** - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash. Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspyers.

**Indeksi i vlerës së qarkullimit nga tregtia me pakicë** - Objektivi i indeksit të vlerës së qarkullimit është të paraqesë ecurinë e tregut.

**Numri i të punësuarve** - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë që punojnë në ndërmarrje (përjashtuar pjesëtarët e familjes që punojnë pa pagesë).

**Indeksi i Numrit të punësuarve** - Indeksi i punësimit paraqet ecurinë e punësimit në ndërmarrjet e anketuara.

### 2.2. Treguesit themelorë

Treguesit - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht 2015 =100.

Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

Indekset - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash.

Ndryshimi vjetor në përqindje - Matë ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më parë. Ndryshimi tremujor në përqindje - Matë ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit.

Rishikimi – Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlerësime të koeficienteve të përdorur etj.

### **3 Tregtia me pakicë**

#### **3.1. Struktura e qarkullimit në sektorin e tregtisë me pakicë**

##### **Tremujori i katërtë 2021 - Tremujorin e tretë 2021**

Në tremujorin e katërtë të vitit 2021 krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2021, rritje ka patur në këto nëngrupe: Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara 34.2%, Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara 27.4%, Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara 12.0%, Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuara 7.7% dhe Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara 6.2%.

Derisa rënie ka shëuar: Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane jo të specializuara 23.0%, Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara 15.9% dhe Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezgja ose tregje 1.1%.

##### **Tremujori i katërtë 2021 - Tremujorin e katërtë 2020**

Në tremujorin e katërtë të vitit 2021 krahasuar me tremujorin e katërtë të vitit 2020 rritje kanë: Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezgja ose tregje 20.0%, Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara 16.1%, Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara 15.5%, Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara 8.4%, Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara 4.9%, Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuara ka shënuar 2.0%, Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara 0.4%.

Derisa rënie ka shënuar: Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara 9.6% .

### **3.2. Numri i të punësuarve në sektorin e Tregtisë me pakicë**

#### **Tremujori i katërtë 2021 - Tremujorin e tretë 2021**

Në tremujorin e katërtë të vitit 2021 krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2021 rritje të numrit të punëtorëve ka: Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara 20.7%, Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara 20.0%, Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara me e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara 17.2%, Tregtia me pakicë e mallrave në dyqane të specializuara 5.8%, Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara 3.7%, Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuara me 2.6%, Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje me 0.6% dhe Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara 0.1%,

#### **Tremujori i katërtë 2021- Tremujorin e katërtë 2020**

Në tremujorin e katërtë të vitit 2021 krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit 2020 rritje të numrit të punëtorëve kanë: Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje 53.4%, Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara 52.2%, Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit në dyqane të specializuara 42.2%, Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara 33.3%, Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara 24.8%, Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara 23.6%, Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara 3.0% .

Derisa rënie ka shënuar: Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuara (16.6%).


## 4 Indeksi i qarkullimit dhe numrit të punësuarve në sektorin e tregtisë me pakicë

### 4.1 Indeksi i qarkullimit në sektorin e tregtisë me pakicë

Tab. 1: Indeksi i qarkullimit në sektorin e tregtisë me pakicë (2015=100)

Nëngrupi (NACE Rev.2)	Aktiviteti ekonomik	2019 TM1	2019 TM2	2019 TM3	2019 TM4	2020 TM1	2020 TM2	2020 TM3	2020 TM4	2021 TM1	2021 TM2	2021 TM3	2021 TM4
471	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara	143,9	171,8	202,3	195,7	174,0	172,8	159,4	204,9	180,5	188,5	198,3	222,1
472	Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara	205,3	237,5	320,9	287,1	191,7	178,1	182,7	258,5	163,7	173,1	183,5	233,8
473	Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuar	117,3	145,4	182,1	166,2	117,3	106,7	93,0	120,1	87,1	111,9	113,9	122,6
474	Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara	160,8	150,9	139,1	135,3	142,3	188,7	167,5	208,8	166,3	201,2	179,7	241,1
475	Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara	158,9	225,6	272,2	255,4	148,9	170,7	222,9	269,4	194,2	240,7	266,1	282,5
476	Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara	167,4	209,9	291,0	357,2	148,7	141,7	180,9	183,5	133,8	224,6	253,3	213,1
477	Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara	94,0	104,3	100,3	100,8	92,6	86,6	65,6	88,2	85,4	105,7	115,0	88,5
479	Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje	231,8	216,6	221,4	223,8	194,0	214,5	130,5	162,2	145,0	196,4	196,8	194,7

Fig. 1: Indeksi i qarkullimit në sektorin e tregtisë me pakicë (2015=100)





**Tab. 1a: Ndryshimi i indeksit të qarkullimit të tregtisë me pakicë nëpër periudha tremujore në raport me tremujorin paraprak**

Nëngrupi (NACE Rev.2)	Aktiviteti ekonomik	2019 TM1	2019 TM2	2019 TM3	2019 TM4	2020 TM1	2020 TM2	2020 TM3	2020 TM4	2021 TM1	2021 TM2	2021 TM3	2021 TM4
		2018 TM4	2019 TM1	2019 TM2	2019 TM3	2019 TM4	2020 TM1	2020 TM2	2020 TM3	2020 TM4	2021 TM1	2021 TM2	2021 TM3
471	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara	-2,6	19,4	17,8	-3,3	-11,1	-0,7	-7,8	28,6	-11,9	4,4	5,2	12,0
472	Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara	14,3	15,7	35,1	-10,5	-33,3	-7,1	2,6	41,5	-36,7	5,8	6,0	27,4
473	Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuara	-13,1	24,0	25,2	-8,7	-29,4	-9,1	-12,8	29,2	-27,5	28,4	1,7	7,7
474	Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara	17,8	-6,2	-7,8	-2,8	5,2	32,6	-11,2	24,7	-20,4	21,0	-10,7	34,2
475	Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara	-3,0	42,0	20,6	-6,2	-41,7	14,6	30,6	20,9	-27,9	23,9	10,6	6,2
476	Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara	8,2	25,4	38,7	22,8	-58,4	-4,7	27,7	1,4	-27,1	67,9	12,8	-15,9
477	Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara	-1,6	11,0	-3,8	0,5	-8,1	-6,5	-24,2	34,4	-3,1	23,8	8,8	-23,0
479	Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje	2,6	-6,5	2,2	1,1	-13,3	10,6	-39,1	24,3	-10,6	35,4	0,2	-1,1

**Tab. 1b: Ndryshimi i indeksit të qarkullimit të tregtisë me pakicë nëpër periudha tremujore në raport me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak**


Nëngrupi (NACE Rev.2)	Aktiviteti ekonomik	2019 TM1	2019 TM2	2019 TM3	2019 TM4	2020 TM1	2020 TM2	2020 TM3	2020 TM4	2021 TM1	2021 TM2	2021 TM3	2021 TM4
		2018 TM1	2018 TM2	2018 TM3	2018 TM4	2019 TM1	2019 TM2	2019 TM3	2019 TM4	2020 TM1	2020 TM2	2020 TM3	2020 TM4
471	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara	8,5	19,7	39,9	32,5	21,0	0,6	-21,2	4,7	3,7	9,1	24,4	8,4
472	Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara	32,8	37,3	81,6	59,9	-6,6	-25,0	-43,1	-10,0	-14,6	-2,8	0,4	-9,6
473	Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuara	-7,6	5,1	33,6	23,2	0,0	-26,7	-48,9	-27,7	-25,7	4,9	22,5	2,0
474	Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara	-15,4	-8,7	-1,2	-0,9	-11,5	25,1	20,4	54,3	16,8	6,6	7,3	15,5
475	Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara	21,5	57,7	66,7	56,0	-6,3	-24,3	-18,1	5,5	30,4	41,0	19,4	4,9
476	Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara	40,8	70,4	116,9	130,8	-11,2	-32,5	-37,8	-48,6	-10,0	58,5	40,0	16,1
477	Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara	-4,3	-3,3	-4,5	5,5	-1,5	-16,9	-34,6	-12,5	-7,8	22,1	75,2	0,4
479	Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje	18,7	7,5	2,5	-1,0	-16,3	-1,0	-41,0	-27,5	-25,2	-8,5	50,7	20,0

## 4.2 Indeksi i numrit të të punësuarve

**Tab. 2: Indeksi i numrit të punësuarve në sektorin e tregtisë me pakicë nëpër periudha**

Nëngrupi (NACE Rev.2)	Aktiviteti ekonomik	2019 TM1	2019 TM2	2019 TM3	2019 TM4	2020 TM1	2020 TM2	2020 TM3	2020 TM4	2021 TM1	2021 TM2	2021 TM3	2021 TM4
471	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara	132,0	131,1	131,7	130,6	128,8	127,5	114,4	133,3	161,8	163,6	166,1	166,3
472	Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara	126,5	127,0	117,0	114,5	117,1	106,1	85,7	125,0	134,1	146,4	147,3	177,8
473	Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuar	143,6	148,5	151,5	154,2	152,2	137,0	91,0	149,5	118,1	139,2	121,5	124,7
474	Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara	111,2	129,0	124,5	127,0	120,9	80,4	76,8	99,8	114,6	128,3	105,3	123,4
475	Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara	128,4	131,8	130,0	127,3	127,2	128,1	117,7	140,2	138,0	139,1	139,2	144,3
476	Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara	110,8	100,3	95,5	105,9	106,8	101,6	104,6	110,8	98,5	118,5	123,1	147,7
477	Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara	133,6	116,8	128,6	126,2	119,1	101,2	93,1	124,3	183,0	176,8	178,7	189,1
479	Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje	108,9	106,1	106,8	105,4	103,8	104,3	93,4	102,7	151,5	141,7	156,8	157,7

**Fig. 2: Numri i të punësuarve në sektorin e tregtisë me pakicë (2015=100)**



**Tab. 2a: Ndryshimi i indeksit të numrit të punësuarve në sektorin e tregtisë me pakicë nëpër periudha tremujore në raport me tremujorin paraprak**

Nëngrupi (NACE Rev.2)	Aktiviteti ekonomik	2019 TM1	2019 TM2	2019 TM3	2019 TM4	2020 TM1	2020 TM2	2020 TM3	2020 TM4	2021 TM1	2021 TM2	2021 TM3	2021 TM4
		2018 TM4	2019 TM1	2019 TM2	2019 TM3	2019 TM4	2020 TM1	2020 TM2	2020 TM3	2020 TM4	2021 TM1	2021 TM2	2021 TM3
471	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara	0,4	-0,6	0,4	-0,8	-1,4	-1,0	-10,3	16,5	21,4	1,1	1,5	0,1
472	Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara	9,4	0,3	-7,8	-2,2	2,3	-9,3	-19,2	45,9	7,2	9,2	0,6	20,7
473	Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuara	9,8	3,4	2,0	1,8	-1,3	-10,0	-33,6	64,3	-21,1	17,9	-12,8	2,6
474	Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara	-1,9	16,0	-3,5	2,0	-4,8	-33,5	-4,5	30,1	14,8	11,9	-17,9	17,2
475	Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara	-2,0	2,6	-1,4	-2,1	0,0	0,7	-8,1	19,0	-1,6	0,8	0,0	3,7
476	Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara	13,4	-9,5	-4,8	10,9	0,8	-4,8	2,9	5,9	-11,1	20,3	3,9	20,0
477	Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara	7,5	-12,6	10,2	-1,9	-5,6	-15,0	-8,0	33,5	47,3	-3,4	1,0	5,8
479	Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje	4,0	-2,6	0,7	-1,3	-1,6	0,5	-10,5	10,1	47,4	-6,4	10,6	0,6

**Tab. 2b: Ndryshimi i indeksit të numrit të punësuarve në sektorin e tregtisë me pakicë nëpër periudha me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak**

Nëngrupi (NACE Rev.2)	Aktiviteti ekonomik	2019 TM1	2019 TM2	2019 TM3	2019 TM4	2020 TM1	2020 TM2	2020 TM3	2020 TM4	2021 TM1	2021 TM2	2021 TM3	2021 TM4
		2018 TM1	2018 TM2	2018 TM3	2018 TM4	2019 TM1	2019 TM2	2019 TM3	2019 TM4	2020 TM1	2020 TM2	2020 TM3	2020 TM4
471	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara	5,1	1,7	0,4	-0,7	-2,4	-2,8	-13,1	2,0	25,7	28,3	45,2	24,8
472	Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara	10,2	3,7	-4,1	-1,0	-7,5	-16,4	-26,7	9,2	14,5	37,9	71,8	42,2
473	Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuara	7,9	2,4	8,2	17,9	6,0	-7,7	-39,9	-3,0	-22,4	1,7	33,4	-16,6
474	Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara	23,3	21,9	14,3	11,9	8,7	-37,7	-38,4	-21,4	-5,2	59,6	37,2	23,6
475	Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara	6,1	1,9	-1,1	-2,8	-0,9	-2,8	-9,4	10,1	8,4	8,6	18,2	3,0
476	Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara	5,9	-4,2	-13,8	8,4	-3,6	1,4	9,6	4,6	-7,8	16,6	17,6	33,3
477	Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara	57,3	8,5	9,8	1,5	-10,9	-13,4	-27,6	-1,5	53,7	74,8	91,9	52,2
479	Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje	33,7	14,1	-0,3	0,6	-4,7	-1,7	-12,6	-2,6	45,9	35,9	67,9	53,4

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**  
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +383 (0) 38 200 31 129  
Kryeshefi Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112
- **Fax:** +383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** [infoask@rks-gov.net](mailto:infoask@rks-gov.net)
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>
- © : Agjencia e Statistikave të Kosovës,
- Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.